

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimet e Disiplinës/ Drejtori i Vorës pezullohet 8 ndeshje, arsyet e bllokimit të merkatos për Tiranën e Vllazninë - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/vendimet-e-disiplines-drejtori-i-vores-pezullohet-8-ndeshje-arsyet-e-bllokimit-te-merkatos-per-tiranen-e-vllaznine
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:05:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:02:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	daeca1c27af9dfa2ea482edab9fa0cd0ee180679d4ab6b378cb5b9ec26aee1ff
TEKSTI	d58ab98052c8648b85564aaabf6860564a4c92a4eed4c6477a083165e56edaef
PAMJA	85dde52972ee9986b6fa45d5067c06b6169243eb9b829ad9bcf5224ccf590066

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a0ce4b6b1b2507db092f65e0c01b80e06ca5258d538030b1ebe5eb7184e093de
E MËPARSHMJA	a9b8330309a9fb615a883c0212351e72f80a55a2f4b0b80e874af4dd5200b18f
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a0ce4b6b1b2507db092f65e0c01b80e06ca5258d538030b1ebe5eb7184e093de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Zgjedhjet në Rusi/ Dalin rezultatet e para, partia 'Rusia e Bashkuar' e mbështetur nga Putini drejt një fitoreje të thellë



Sport

Vendimet e Disiplinës/ Drejtori i Vorës pezullohet 8 ndeshje, arsyet e bllokimit të merkatos për Tiranën e Vllazninë

Jo vetëm për dy klubet e Superligës, por ka bllokim merkatoje edhe për ekipet e kategorive të tjera në futbollin shqiptar.



Baneri i Komisionit të Disiplinës



Redaksia

17 Shtator, 17:00 | Përditësimi: 17 Shtator, 17:03

f Share Tweet

A A

Komisioni i Disiplinës ka publikuar vendimet për javën e fundit të futbollit shqiptar ku fillimisht bien në sy gjatë për klube si Laçi, Vllaznia, Tirana dhe Skënderbeu për sjellje të gabuar të tifozëve.

Tetë ndeshje pezullim ka marrë drejtori i Vorës Bazion Tragaj për sjellje jo sportive ndaj gjyqtarëve, ndërsa komisioni ka bërë të ditur edhe arsyet e bllokimit të merkatos për disa klube të futbollit shqiptar ndër të cilat edhe Tirana. Sipas disiplinës bardheblutë kanë humbur gjyqet ndaj Romeo Harizajt dhe Gledi Micit.

Vendimet e disiplinës:



LEXO EDHE:

Xhixha i përgjigjet dy herë verdhebluve, s'ka fitues në Tirana-Elbasani! Ndeshja pa tifozë

1. KF Laçi, për mosmarrjen e masave të nevojshme për garantimin e rendit dhe sigurisë, si dhe për sjellje të gabuar të spektatorëve, të cilët kanë hedhur sende në fushën e lojës, duke rrezikuar sigurinë e lojtarëve të ekipit kundërshtar, në bazë të neneve 17/1 dhe 17/2/b të KDE, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. KF Vllaznia, për sjellje të gabuar të spektatorëve, duke hedhur sende në fushën e lojës, në bazë të nenit 17/2/b të KDE, dënohet me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Lojtari i KF Vllaznia, Adnard Mehmeti, për provokim të spektatorëve, në bazë të nenit 14/1/f të KDE, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga veprimtaritë.
4. KF Skënderbeu, për sjellje të gabuar të spektatorëve, duke ndezur flakadanë dhe duke hedhur sende



- në fushën e lojës, në bazë të neneve 17/2/b dhe 17/2/c të KDE, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
5. **KF Tirana**, për sjellje të gabuar të spektatorëve, duke ndezur flakadanë dhe mjete të tjera piroteknike, në bazë të nenit 17/2/b të KDE, dënohet me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
6. Zyrtari i KF Tirana, Omer Bunjaku, për protestë ndaj vendimeve të zyrtarëve të ndeshjes, në bazë të nenit 14/1/c të KDE, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga veprimtaritë.
7. KF Teuta, në bazë të nenit 6/1/a të KDE, paralajmërohet se, në rast të përsëritjes së problematikave teknike apo organizative që shkaktojnë ndërprerjen e zhvillimit normal të ndeshjes, do të jetë subjekt i masave disiplinore të parashikuara në Kodin e Disiplinës dhe Etikës dhe në rregulloret e **FSHF**.
8. Zyrtari i KF Vora, Bazion Tragaj, për sjellje jospportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes në mënyrë të përsëritur, në bazë të neneve 14/1/j dhe 33 të KDE, dënohet me 8 (tetë) ndeshje pezullim nga veprimtaritë. Në zbatim të nenit 6/2/b të KDE, zyrtarit i ndalohej hyrja në dhomat e zhveshjes dhe ambientet e brendshme të stadiumit, deri në përfundim të dënimit.
9. KF Oriku, për mosrespektimin e detyrimeve dhe rregulloreve të aktivitetit, duke shkaktuar vonesë në fillimin e ndeshjes, në bazë të neneve 8/1 dhe 17/1/b të KDE, dënohet me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Sipas nenit 76/1/a të KDE, gjoba aplikohet në masën 50%.
10. Zyrtari i Luzi Vogël 2008, Albert Lusha, për sjellje jospportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes, në bazë të nenit 14/1/j të KDE dënohet me 4 (katër) ndeshje pezullim nga aktiviteti.
11. Zyrtari i KF Shiroka, Ardit Mani, për sjellje jospportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes, në bazë të nenit 14/1/j të KDE dënohet me 4 (katër) ndeshje pezullim nga aktiviteti.
12. Zyrtari i KF Shiroka, Ergi Axhani, për protestë ndaj vendimeve të zyrtarëve të ndeshjes, në bazë të nenit 14/1/c të KDE, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga veprimtaritë.
13. Akademia e Futbollit U-18, për mospërmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi duke shkaktuar braktisjen e ndeshjes së vlefshme të kampionatit Abissnet Superiore U-18, kundër KF Vora U-18, në bazë të nenit 16/1 të KDE, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe humbet ndeshjen në tavolinë me rezultatin 3-0. Sipas nenit 76/1/e të KDE, gjoba të aplikohet në masën 3%.
14. KF Tirana, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 19, datë 16.10.2025 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Romeo Harizaj kundër KF Tirana, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
15. KF Tirana, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 20, datë 03.11.2025 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Gledi Mici kundër KF Tirana, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
16. KF Vllaznia, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 08, datë 11.06.2025 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Liridon Latifi kundër KF Vllaznia, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
17. FC Besa, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 22/1, datë 02.12.2025 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Emiljano Çela kundër FC Besa, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
18. FC Besa, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 23/1, datë 02.12.2025 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Bekim Kuli kundër FC Besa, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
19. KF Lushnja, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 11, datë 30.04.2026 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në çështjen Ardit Hoxhaj kundër KF Lushnja, në bazë të nenit 29/1/c të KDE, vendoset ndalimi i regjistrimit të lojtarëve të rinj për 3 (tre) periudha regjistrimi deri në pagesën e plotë të detyrimit.
20. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Kleandro Lleshi. Klubi i Futbollit Tirana, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 14, datë 19.06.2026 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në bazë të nenit 29/1/b të KDE, Klubit të Futbollit Tirana i jepet një afat paralajmëruar prej 30 (tridhjetë) ditësh për të ekzekutuar vendimin.
21. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Fatmir Prengaj. Klubi i Futbollit Tirana, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 10, datë 08.04.2026 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në bazë të nenit 29/1/b të KDE, Klubit të Futbollit Tirana i jepet një afat paralajmëruar prej 30 (tridhjetë) ditësh për të ekzekutuar vendimin.
22. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Erisildo Smaçi. Klubi i Futbollit Tirana, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 07, datë 25.03.2026 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në bazë të nenit 29/1/b të KDE, Klubit të Futbollit Tirana i jepet një afat paralajmëruar prej 30 (tridhjetë) ditësh për të ekzekutuar vendimin.
23. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Ildi Gruda. Klubi i Futbollit Vllaznia, për dështim në ekzekutimin e vendimit nr. 04, datë 19.02.2026 të Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në bazë të nenit 29/1/b të KDE, Klubit të Futbollit Tirana i jepet një afat paralajmëruar prej 30 (tridhjetë) ditësh për të ekzekutuar vendimin.
24. Pranimin e kërkesës së lojtarit të KF Iliria, Brajan Selmani, pezullimin e pjesës së mbetur të dënimit. Periudha e pezullimit me kusht, në zbatim të nenit 34/1 të KDE, do të jetë 6 (gjashtë) muaj.
25. Pranimin e kërkesës së lojtarit të KF Oriku, Bruno Telushi, pezullimin e pjesës së mbetur të dënimit. Periudha e pezullimit me kusht, në zbatim të nenit 34/1 të KDE, do të jetë 6 (gjashtë) muaj.
26. Rrëzimin e kërkesës së lojtarit të KF Lushnja, Nelson Joseph Pius, si të pabazuar në Kodin e Disiplinës dhe Etikës.
27. Rrëzimin e kërkesës së lojtarit të KF Burreli, Indri Rrani, si të pabazuar në Kodin e Disiplinës dhe Etikës.

28. Rrëzimin e kërkesës së lojtarit të KF Tirana U-18, Klejdi Gjini, si të pabazuar në Kodin e Disiplinës dhe Etikës.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 3 (tre) ditëve përpara Komisionit të Apelit.

Ne.k./Shqiptarja.com

TAG: [Vllaznia](#) [kf tirana](#) [fshf](#) [komisioni i disiplinës](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Sot Tirana-Elbasani, Gvozdenovic: Respekt për kundërshtarin por duam fitoren! Dinamo për rekord, Daja: Meritat i kanë futbollistët

20 Shtator, 12:48



Vllaznia prek fundin pas humbjes 0-2 me Teutën! Xhaferri kërkon dorëheqjen e Martinit, tifozët sulmojnë autobusin e durrsakëve (VIDEO)

18 Shtator, 23:01



Humbja e 3 radhazi, Vllaznia zhytet në krizë! Teuta 3 pikë karakteri në Shkodër

18 Shtator, 20:46



Sonte Vllaznia-Teuta, Musta: Do të ringrihem shumë shpejt, nga Elbasani më larguan me një ofertë qesharake

18 Shtator, 11:58



Vetëm pak ditë pas zhblokimit, telashe për Tiranën! FIFA i bllokoi sërish merkaton

17 Shtator, 15:15



'Ke shitur ndeshje!' Akuza të forta në Shkodër, replikon presidenti i Vllaznisë: Shko në prokurori

16 Shtator, 16:07



'Bërryli ndaj meje shpalli Egnatian kampione', Gurishta i Vllaznisë: S'besoj se Hysaj do luajë në Shqipëri, ka oferta nga jashtë

12 Shtator, 14:43



Sherri kundër Brazilit dhe Kombëtarja e minifutbollit pa mbështetjen e FSHF-së, trajneri Sejko për Report TV: Në Botëror pa doktor

 **Ernest Koçi**

11 Shtator, 13:05



Rikthimi në shtëpi, pritet mbështetja e 4 mijë korçarëve! Sot Skënderbeu-Tirana, Ahmataj: Llogarisim vetëm 3 pikët

11 Shtator, 12:55



Vllaznia dhe Flamurtari e pësojnë nga tifozët, gjobë edhe për Besën e Burrelin! Ilir Daja kthehet për derbin

10 Shtator, 17:09



Dinamo përmbys Elbasanin, trajneri Gvozdenovic: Situatë e keqe, por me punë e kalojmë! Tirana merr fitoren e parë

7 Shtator, 11:02



Partizani mori 3 pikët e para, zv/trajneri i Vllaznisë: Na mungoi përqendrimi! Sot Tirana-Vora dhe Dinamo-Elbasani

6 Shtator, 12:47

Kodi Etik

Kontakt

Breth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.